

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti i Filologjisë

Lënda: Dialektologji

Lëndë obligative. Niveli bachelor.

Viti i III i studimeve. Semestri V

Numri i orëve në javë: 3 + 2

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 5

Koha/lokacioni: E enjte: 10:00 -12:15.

Salla nr. 88.

Mësimdhënësi i kursit: Prof. ass. dr. Haki Hysenaj

Detaje kontaktuese: Zyra nr. 131. Telefoni: 044-125-005. e-mail: h_hysenaj@hotmail.com.

Konsultime me studentë: të mërkurën nga 10:00-12:00 dhe të enjten nga 12:15-13:00.

Qëllimet e kursit: Në lëndën “Dialektologji” studentët do të përvetësojnë njohuri për shqipen dialektore, sistemet e saj, dialektet, nëndialektet, grupet e të folmeve dhe njohuri te caktuara për të folme të veçanta.

Në pjesën e parë të këtij kursi studentëve do t’u shpjegohet historiku i lëndës së dialektologjisë, metodat e studimit të saj, përvojat e të tjerëve në këto studime, ndërsa në pjesën e dytë studentëve do t’u flitet për shtrirjen e shqipes brenda kufijve natyrorë, si dhe për shqipen dialektore që flitet në ngulimet e hershme shqiptare në Greqi, Itali, Bullgari, Ukrainë dhe në Zarë të Kroacisë.

Lënda e Dialektologjisë cilësohet si lëndë e rëndësishme për mësimin e fonetikës, morfologjisë, sintaksës dhe semiologjisë e frazeologjisë së gjuhës. Në të njëjtën kohë kjo lëndë sot bëhet edhe më e rëndësishme pasi që liberalizimi i sistemit dhe i shoqërisë ka nxitur tash e dy decaie debate për mënyrën e formimit të standardit. Këto debate kanë vënë në qarkullim institucionet që të rishikojnë atë, natyrisht duke e ruajtur gjithnjë strukturën e tij, por duke synuar që e njëjta të përmirësohet dhe të bëhet e tillë që folësit e saj ta ndiejnë për të veten dhe të ndihen komod gjatë përdorimit.

Prurjet nga dialektet në standardin e sotëm janë më se evidente, prandaj në këtë kurs do të flitet edhe për raportet gjuhë standarde-dialekte.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje:

1. Të identifikojnë dhe të mbledhin material dialektor me ndihmën e metodave tashmë të zbatueshme në këtë disiplinë gjuhësore.
2. Do të aftësohen që të identifikojnë materialet gjuhësore sipas përkatësisë së tyre dialektore.
3. Do të aftësohen të bëjnë krahasime midis dialekteve, nëndialekteve dhe të folmeve të shqipes.
4. Do të jenë në gjendje që të kthejnë tekste të ndryshme nga gjuha dialektore në gjuhën standarde.

5. Do të aftësohen të identifikojnë të folurit e njerëzve dhe prejardhjen e tyre regjionale varësisht nga gjuha që përdorin.
6. Do të aftësohen që përmes kësaj lënde të marrin njohuri edhe për etnolinguistikën dhe etnologjinë.
7. Do të aftësohen për të dalluar trajtat dialektore nga ato të standardit, aftësim ky që do t'u ndihmojë në përvetësimin sa më të mirë të standardit të shqipes.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime, diskutime, punë në terren, punime seminari, prezantime.

Literatura bazë: Jorgji Gjinari-Gjovalin Shkurtaj, Dialektologjia, Tiranë, 2003; Agnia Desnickaja, Gjuha shqipe dhe dialektet e saj, Prishtinë, 1973.

Plani i detajuar i mësimit:

Java e parë:

- Njohuri të përgjithshme
- Kufiri dialektor (izoglosa)
- Shkolla e Parisit
- Shkolla zvicerane
- Faktorët që ndikojnë në ndarjen dialektore
- Vendbanimi dhe komunikimi

- Shkaqet gjeografiko-historike
- Shkaqet e reja
- Grupet speciale te shkaqeve

Java e dytë

- Konceptet dialektologjike dhe terminologjia
- Faza e parë e studimeve dialektologjike
- Faza e dytë e studimeve dialektologjike
- Faza e tretë e studimeve dialektologjike
- Terminologjia
- Gjuha dhe dialektet, marrëdhëniet midis tyre
- Rasti i shqipes
- Shtrirja territoriale e gegërishtes
- Shtrirja territoriale e toskërishtes
- Përfundime

Java e tretë

- Dialekti dhe gjuha e shkruar standarde
- Dialektologjia dhe etnologjia
- Dialektologjia dhe folklori
- Studimet e dialekteve (metodologjia)
- Rasti i shqipes
- Anketa

- Vrojtimi i drejtpërdrejtë

Java e katërt

- Ndarja dialektore e gjuhës shqipe
- Dialektet
- Të folmet kalimtare
- Nëndialektet
- Grupet e të folmeve
- Historia e ndarjes dialektore të shqipes

Java e pestë

- Dallimet dialektore në fushë të shqipes
- Sistemi vokalik i shqipes
- Dallimet dialektore në numrin e fonemave
- Zanoret e theksuara/zanoret e patheksuara
- Zanoret hundore
- Zanoret e gjata
- Diftongje dhe togje zanoresh

Java e gjashtë

- Sistemi konsonantik i shqipes
- Dallimet dialektore në numrin e fonemave konsonantike
- Grupet konsonantike-përndarja dialektore

- Dallimet funksionale të fonemave konsonantike
- Dallimet e kushtëzuara/të pakushtëzuara

Java e shtatë

- Dallimet dialektore në fushë të morfologjisë
- Dallimet në sistemin emëror
- Emri
- Mbiemri
- Përemri
- Numërori
- Dallimet në sistemin foljor
- Folja
- Foljet pavetore
- Mënyra dëftore
- Mënyra lidhore
- Mënyra urdhërore
- Foljet pavetore

Java e tetë

- Format e pashtjelluara foljore
- Paskajorja
- Format foljore aspektive

Java e nëntë

- Vlerësim intermediar

Java e dhjetë

- Marrëdhëniet e gjuhës standarde shqipe me dialektet
- Ndikimi i gjuhës standarde në mënjanimin e dallimeve dialektore
- Perspektiva e hyrjes së varianteve dialektore në standard

Java e njëmbëdhjetë

- Arbëreshët e Italisë-histori, identitet, gjuhë
- Historiku i studimit të të folmeve arbëreshe
- Realiteti i sotëm sociolinguistik
- Dygjuhësia te arbëreshët
- Autore dhe tekste
- Vendbanime
- Arbërishtja dhe perspektiva e saj

Java e dymbëdhjetë

- Arbëreshët e Greqisë-histori, identitet, gjuhë
- Shtegtimet
- Vendbanimet
- Etnografia dhe gjuha e arvanitasve
- Autorë dhe tekste

- Gjuha arvanitase-shqipja standarde (krahasime)
- Statusi gjuhësor
- E folmja e arvanitasve të Salaminës

Java e trembëdhjetë

- Arbëneshët e Zarës, histori, identitet, gjuhë
- Realiteti sot
- Perspektiva
- Arbëreshët e Mandricës
- Gjuha, perspektiva

Java e katërbëdhjetë

- Shqiptarët e Ukrainës, identiteti dhe gjuha
- Shtegtimi
- Origjina
- Gjuha
- Perspektiva gjuhësore
- E folmja e Kelmendit të Peshterit
- E folmja e kelmendasve të Sremit

Literatura shtesë: Bahri Beci, Rreth bazës dialektore të shqipes standarde, Filologji nr. 2, Prishtinë, 1997; Bahri Beci, Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës, Tiranë, 1995; Seria e botimeve “Dialektologjia shqiptare” nga ASHRSH; Studime gjuhësore I (Dialektologji), IA, Prishtinë, 1978; Idriz Ajeti, Zhvillimi historik i të folmes gege të

Arbëneshëve të Zarës, ASHAK, Prishtinë, 1997; Waslav Cimočovski, Dialekti i Dushmanit”, në librin e ASHAK “Për gjuhën shqipe”, Prishtinë, 2004; Imri Badallaj, E folmja e Hasit, Prishtinë, 2001; Fadil Raka, Gjuha e standardizuar shqipe dhe toskërishtja letrare, Filologji nr. 10, Prishtinë, 2002; Fadil Raka, Areali gjuhësor i Kaçanikut”, Prishtinë, 2004, Gjovalin Shkurtaç, Ligjërimet arbëreshe, Tiranë, 2006; I. Voronina, M. Domosileckaja, L. Sharapova, E folmja e shqiptarëve të Ukrainës, Shkup, 1996; Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe I-II, 2008.

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi intermediar: 10%

Detyrat dhe punimet e seminareve: 10 %

Puna në terren 20 %

Vijimi i rregullt: 5 %

Provimi final 55 %

Total: 100 %

Provimi mbahet me shkrim dhe me gojë.